



“Afrojuni përsosmërisë dhe jini mesatarë! Dijeni se asnjëri prej jush nuk do të shpëtojë (nga Zjarri) me veprat e tij. - O i Dërguari i Allahut, as ti?! - e pyetën të pranishmit. - “As unë, përveç nëse Allahu më përfshin me mëshirën dhe mirësinë e Tij, - tha Profeti ﷺ”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Afrojuni përsosmërisë dhe jini mesatarë! Dijeni se asnjëri prej jush nuk do të shpëtojë (nga Zjarri) me veprat e tij. - O i Dërguari i Allahut, as ti?! - e pyetën të pranishmit. - “As unë, përveç nëse Allahu më përfshin me mëshirën dhe mirësinë e Tij, - tha Profeti ﷺ.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ i inkurajonte sahabët që të veprojnë dhe t'i frikësohen Allahut aq sa munden, pa teprim dhe cungim, dhe që me veprat e tyre të synojnë saktësinë, duke qenë të sigurtë me Allahun dhe ta ndjekin sunetin, në mënyrë që veprat e tyre të pranohen dhe të bëhen shkak për zbritjen e mëshirës mbi ta. Pastaj tregoi se askënd nuk do ta shpëtojë vetëm veprat e tij, por medoemos kjo ndodh përmes mëshirës së Allahut. Ata thanë: "Edhe ti, o i Dërguari i Allahut, a nuk do të shpëtohesh me veprat e tua, pavarësisht madhëstisë së pozitës sate?" Ai tha: "Edhe unë, përveç nëse Allahu më mbulon me mirësinë e mëshirës së Tij."

<https://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3469>

